



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Shqyrtimi i Gjashtë i Tarifave të Energjisë Elektrike SHTE6 (2012-2013)

Raporti Konsultativ për KEK-un

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE me qëllim të marrjes së komenteve eventuale nga palët e interesit. Ai nuk paraqet vendim të ZRRE-së.

27 shkurt 2012

Përmbajtja

1	Hyrje	3
2	Ndryshimet Ligjore	3
2.1	Ndryshimet legislative	3
2.2	Struktura tarifore dhe alokimi i kostos.....	4
2.3	Periudha e përcaktimit të çmimeve	5
3	Struktura e këtij dokumenti	5
4	Balanca e Energjisë	5
4.1	Shitjet përfundimtare	6
4.2	Humbjet.....	6
5	Përshtatjet	7
5.1	Përshtatja e RAB _r -it.....	8
5.2	Përshtatja e RAB-it.....	8
5.3	Përshtatja e importit	8
5.4	Përshtatja për shkak të transferimit të transformatorëve 110kV	9
5.5	Kostot për furnizim intern të energjisë elektrike	9
5.6	Shpenzimet kapitale për Divizionin e Gjenerimit	10
5.7	Të hyrat e palës së tretë për Operatorin e sistemit të shpërndarjes (OSSH)	10
6	Bashkërenditja	10
6.1	Kostot operative dhe të mirëmbajtjes	10
6.2	Kostot që kanë të bëjnë me kontestin me KOSTT-in.....	11
6.3	Kostoja që kanë të bëjnë me importin	11
6.4	Kostoja që ka të bëjë me eksportin	11
6.5	Kostoja që ka të bëjë me shpenzimet kapitale.....	11
7	Propozimet e ZRRE-së	12
7.1	Margjina e shitjes me pakicës	12
7.2	Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (WACC)	13
7.2.1	WACC e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes	14

Përbajtja

7.3	Çmimi i eksportit	15
7.4	Kostoja e lejuara operative dhe e mirëmbajtjes	15
8	Përmbledhje.....	15

1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është në procesin e Shqyrtimit të Gjashtë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE6). Procesi i shqyrtimit të tarifave ngërthen përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) që të licencuarit në shqyrtim i lejohet të mbledhë për shërbimet e rregulluara që ofron. MAR-i i përcaktuar me këtë shqyrtim pritet të hyjë në fuqi që nga 1 prilli 2012.

Ky Raport Konsultativ parashtron këndvështrimin e ZRRE-së lidhur me Aplikacionin e KEK-ut për të Hyra Maksimale të Lejuara për komponentët e Gjenerimit, Shpërndarjes dhe Furnizimit të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), të cilat i janë parashtruar ZRRE-së. Aplikacionet janë publikuar në faqen e internetit të ZRRE-së së bashku me këtë Raport Konsultativ.

KEK-u i ka parashtruar ZRRE-së si format e shabllonizuara ashtu edhe llogaritjet e veta të veçanta në emër të kërkesës së tyre në SHTE6. Në këtë dokument, ZRRE iu referohet shifrave të KEK-ut të raportuara në shabllone.

ZRRE fton palët e interesit që të ofrojnë komente rreth qëndrimeve të veta të shprehura në këtë Raport Konsultativ. Komentet përkritazi me këto propozime do të pranohen deri më 12 mars 2012 dhe duhet të dërgohen me postë elektronike në ero.pricing-tariffs@ero-ks.org, me titullin “Komentet për SHTE6”, ose me postë në adresë të ZRRE-së: Rr. Hamdi Mramori nr.1, 10000 Prishtinë, Kosovë, ku në rubrikën e lëndës të shkruhet për “Departamentin e Çmimeve dhe Tarifave”.

Në këtë fazë, ZRRE nuk ka marrë vendim mbi MAR i cili do të hyjë në fuqi më 1 prill. Këto janë propozime preliminare. ZRRE fton të gjitha palët e interesit të japin komente mbi këndvështrimet e ZRRE-së të parashtruara në këtë dokument.

2 Ndryshimet Ligjore

2.1 Ndryshimet legislative

Në tetor të vitit 2010 Parlamenti i Kosovës ka miratuar Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185. Ky ligj ka imponuar ndryshime të nevojshme në metodologjinë tarifore të ZRRE-së. Ato me ndikim më të madh janë përmbledhur në vijim:

1. Ligji i ri për rregullatorin e energjisë kërkon që, për qëllime të llogaritjes së të hyrave maksimale të lejuara, ZRRE të njeh vlerën pozitive¹ të aseteve para 2006 në Bazën Rregullative të Aseteve².

¹ Sipas metodologjisë së mëhershme, këto asete kishin vlerën zero.

² Sipas Rregullave të çmimores, Baza Rregullative e Aseteve përfaqëson shumën e aseteve të përdorura dhe të dobishme të subjektit të rregulluar.

2. Ndër-subvencionet ndërmjet kategorive të ndryshme të konsumatorëve duhet të eliminohen deri me 31 dhjetor 2014³.
3. Ligji i ri mbi rregullatorin e energjisë kërkon që rregullatori t'i lejojë subjektit të rregulluar që të rikthejë një shumë të arsyeshme të borxheve të këqija⁴.

Përmes një procesi interaktiv të konsultimit, ZRRE ka ndryshuar metodologjinë e saj të tarifave për të pasqyruar ndryshimet në ligj. Në shtator të vitit 2011, Bordi i ZRRE-së ka miratuar metodologjitë vijuese të reja që qeverisin rregullimin e sektorit të energjisë elektrike:

1. Rregulla për vënien e çmimeve të gjenerimit;
2. Rregulla për vënien e çmimeve të operatorit të sistemit të transmisionit dhe të tregut (TSO/MO);
3. Rregulla për vënien e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes (OSSH);
4. Rregulla për vënien e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike.

Gjatë shqyrtimit të kërkesave të KEK-ut, ZRRE ka pasuar metodologjitë e reja të përvetësuara, me përjashtimet e cekura në Pjesën 2.2 të këtij dokumenti.

2.2 Struktura tarifore dhe alokimi i kostos

Të licencuarit janë të obliguar t'i dorëzojnë metodologjitë e ngarkesave për aprovim të ZRRE-së. Këto metodologji përdoren për të konvertuar të hyrat e lejuara të mbledhura nga shitjet e rregulluara në tarifa dhe ngarkesa.

ZRRE konsideron se është e nevojshme të ketë kohë të mjaftueshme për t'u konsultuar për këto metodologji, duke pasur parasysh ndikimin e madh që kanë në kategoritë e ndryshme të konsumatorëve. ZRRE ka përgatitur draftet e parimeve të ngarkesave për të udhëzuar përgatitjen e metodologjive⁵ dhe është duke bërë një studim lidhur me kostot e furnizimit ndaj kategorive të ndryshme të konsumatorëve të cilat do t'i shërbejnë ZRRE-së për të vendosur nëse tarifat janë kost-reflektive, siç kërkohet me ligj. ZRRE do t'i publikojë këto parime si dhe analizën e kostos pas përfundimit të SHTE6 dhe, rrjedhimisht, do t'i ftojë të licencuarit t'i ofrojnë metodologjitë e ngarkesave për shqyrtim e konsultim.

³ Neni 40.2 i Ligjit mbi rregullatorin e energjisë

⁴ Deri në ETR5, ZRRE nuk iu lejonte kompanive të rikthejnë kostot e borxheve të këqija.

⁵ Është përgjegjësi e të licencuarve për të zhvilluar metodologjitë e ngarkesave. Qëllimi i këtyre parimeve është për t'u ndihmuar të licencuarve në zhvillimin e tyre duke paraqitur qëndrimet e ZRRE-së për parimet që duhen ndjekur në metodologji mbi të cilat ZRRE do të marrë vendim se a të aprovojë apo mos t'i aprovojë metodologjitë e propozuara.

ZRRE thekson se KEK-u ka përfshirë një propozim për metodologjinë e alokimit të kostove në aplikacionin e SHTE6. Kjo nuk është metodologji e ngarkesave pasi që nuk sqaron se si kostot e alokuara ndaj kategorive të ndryshme të konsumatorëve do të shndërrohen në tarifa. ZRRE është duke konsideruar alokimin e kostos të propozuar nga KEK-u dhe do të komentojë në të në kuadër të Raportit Konsultativ që ka të bëjë me alokimin e kostos.

Megjithatë, për shqyrtimin SHTE6, ZRRE propozon që struktura tarifore të mos ndryshojë dhe do t'i përshtatë të gjitha tarifat me nivelin e njëjtë të përqindjes.

2.3 Periudha e përcaktimit të çmimeve

Rregullat e Çmimeve të aprovuara nga ZRRE lejojnë periudhën tranzicionale një vjeçare për të gjithë të licencuarit përveç gjeneratorëve të rregulluar të KEK-ut të cilët, sipas Rregullave, duhet të kalojnë menjëherë në rregullim shumë-vjeçar tarifor. Duke pasur parasysh kohën e shkurtë në dispozicion për SHTE6, ZRRE konsideron që është joreale të përcaktohet kontrolli shumëvjeçar për gjeneratorin e rregulluar dhe, për këtë arsye, do të aplikojë kontroll një-vjeçar për gjeneratorin e rregulluar.

3 Struktura e këtij dokumenti

Ky Raport Konsultativ është i organizuar si në vijim:

- Në pjesën 4 shtjellohen projeksionet e KEK-ut mbi kërkesën për energji, humbjet, furnizimin dhe energjinë e importuar.
- Në pjesën 5 shtjellohen propozimet e KEK-ut mbi MAR për komponentën e gjenerimit.
- Në pjesën 6 shtjellohen propozimet e KEK-ut mbi MAR për komponentën e operatorit të sistemit të distribucionit.
- Në pjesën 7 shtjellohen propozimet e KEK-ut mbi MAR për komponentën e Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike.
- Në pjesën 8 jepet përmbledhja e propozimeve të ZRRE-së mbi tarifat e rregulluara që do të hyjnë në fuqi nga 1 prilli 2011.

4 Balanca e Energjisë

Balanca e Energjisë e përdorur për qëllime të llogaritjes së të Hyrave të Lejuara krijohet duke përdorur qasjen nga poshtë-lartë. Së pari, vlera e shitjeve përfundimtare të energjisë për konsumatorët e distribucionit merren nga Balanca e Energjisë e cili aprovohet nga MZHE⁶, e ndryshuar krahas rritjes së shitjeve të ndërlydhura me uljen e humbjeve teknike dhe komerciale. Vlera

⁶ Ministria për zhvillim ekonomik

e humbjeve të distribucionit të lejuara nga ZRRE dhe gjenerimi i kyçur në distribucion i shtohen kësaj vlere, dhe fitohet vlere e energjisë që hyn në distribucion. Shuma e kësaj vlere, humbjet në transmision dhe konsumi i transmisionit pastaj krahasohen me gjenerimin vendor dhe me eksportet. Ndryshimi ndërmjet tyre mbulohet nga importi.

4.1 Realizimi përfundimtar

Vlera e realizimit përfundimtar është përcaktuar nga ZRRE bazuar në nivelin e realizimit përfundimtar të parashikuar me versionin e fundit të Bilancit të Energjisë dhe supozimeve të ZRRE-së për kthimin e humbjeve të zvogëluara komerciale në realizim. ZRRE supozoi se ulja e humbjeve prej 1 GWh shpie në rritje të realizimit prej 0.9 GWh ku 0.1 GWh të mbetura ulin importin ose, në muaj të caktuar, rrisin eksportet.

4.2 Humbjet

Nga kërkesa e KEK-ut për tarifa, është e qartë se KEK-u i është përgjigjur pozitivisht insistimit të ZRRE-së që KEK-u të zvogëlojë humbjet në distribucion pasi që KEK-u tashmë ka zvogëluar humbjet në distribucion (teknike dhe komerciale) për 3.15% (pikë përqindjeje) deri në nivel të prej 38.08% (pikë përqindjeje).

Bordi i ZRRE-së ka aprovuar caqet për zvogëlimin e humbjeve për periudhën kalimtare dhe për periudhën e ardhshme 5 vjeçare të rishqyrtimit të tarifës. Caqet e uljes së humbjeve janë dhënë në tabelën vijuese. Vlera e realizuar fillestare e humbjeve është 38.08%⁷.

Viti	Caku	Humbjet
1	3.0%	35.08%
2	3.0%	32.08%
3	3.0%	29.08%
4	2.5%	26.58%
5	2.5%	24.08%
6	2.5%	21.58%

Tabela 1: Caqet indikative të zvogëlimit të humbjeve të aprovuar nga Bordi i ZRRE-së⁸

Vlera totale e lejuar e ZRRE-së e humbjeve në nivel distribicioni prandaj është 35.08%. Ky nivel i humbjeve lejohet nga ZRRE me supozimin se humbjet e alokuara transformatorëve 110kV/x do të vazhdojnë të mbeten në kuadër të operacioneve të KEK-ut deri në shqyrtimin e radhës të tarifës.

Niveli i nënkuptuar i importit prandaj është 800.8 GWh.

Përmbledhja e Bilancit të Energjisë është dhënë në tabelën vijuese

⁷ Kjo vlerë përfshin energjinë e pafaturuar në enklava prej 4.5% (pikë përqindjeje)

⁸ Vendimi V_393_2011 i datës 29 dhjetor 2011

		-- 2012 -- Aplikimi	-- 2012 -- Propozimi I ZrRE
Gjenerimi			
Gjenerimi I KEK-ut			
Kosova A	GWh	1,552.3	1,475.3
Kosova B	GWh	3,470.2	3,392.5
Gjenerimet tjera vendore			
HPP Ujmani	GWh	82	82
Shperndarja nderlidhur-gjenerimi	GWh	52	52
Iportet dhe Eksportet			
Importet	GWh	824.7	800.8
Eksportet	GWh	-169.8	-183.7
Humbjet ne Transmision			
Humbjet e transmisionit	%	2.23%	2.07%
	GWh	132.2	119.0
Kerkesa në Transmision			
Shitjet per konsumatorët e kyçur në transmision			
220kV (Feronikeli)	GWh	657.0	657.0
110kV (perfshire Trepca)	GWh	87.6	87.5
Konsumi I KEK-ut	GWh	299.4	131.4
Humbjet ne shperndarje dhe energjia e pafaturuar			
Humbet ne shperndarje dhe energjia e pafaturuar	%	37.19%	35.04%
	GWh	1,723.8	1,619.9
Kerkesa e kyçur në Shpërndarje			
Shitjet tek klientet e kyçur në shperndarje	GWh	2,910.9	3,003.6
Balanca	GWh	0.0	0.0

Tabela 2: Balanca e Energjisë i përdorur për llogaritjen e të Hyrave të Lejuara

5 Përshtatjet

Kjo pjesë e Raportit Konsultativ shtjellon përshtatjet që ZRRE i ka bërë aplikacionit të KEK-ut. ZRRE nuk ka dhënë ndonjë gjykim mbi arsyeshmërinë e kërkesës së KEK-ut në këtë pjesë. Qëllimi i përshtatjeve është të prezantohen ndryshimet në Aplikacionin e KEK-ut të cilat janë bërë për shkak se aplikacioni nuk ishte në përputhje Rregullat e ZRRE-së. Pjesa e ndryshimeve, në këtë rast, përfshin vlera të azhurnuara të kërkesës së KEK-ut që nga parashtrimi fillestar.

5.1 Përshtatja e RAB_f-it

ZRRE vëren se KEK-u ka vendosur vlerën fillestare të RAB_f-it (vlerës së aseteve që përdoret për llogaritjen e kthimit të lejuar) në nivel më të lartë se ai i përdorur nga ZRRE. KEK-u ka fituar këtë vlerë duke zbritur vlerën e granteve nga vlera bruto fillestare e aseteve. ZRRE vëren se kjo është e pasaktë pasi që ZRRE lejon amortizimin por jo edhe kthimin në asete para 2006, pasi që nuk ka kosto financiare të ndërlidhura me këto asete. Ky qëndrim është qartësuar nga ZRRE në dokumentin e vet të konsultimit mbi RAB të publikuar nga ZRRE më 1 gusht 2011. RAB_f-ja fillestare prandaj duhet të vendoset në vlerën zero.⁹

5.2 Përshtatja e RAB-it

Ndërmjet viteve 2006 dhe 2011, KEK-u ka azhurnuar RAB dhe RAB_f duke përdorur amortizimin nga llogaritë e audituara financiare. Në këto përdoret jetëgjatësia më e shkurtër e aseteve sesa ajo që përdorë ZRRE ku, si rezultat, amortizimi i supozuar në periudhën 2006 – 2011 është më i lartë sesa që ishte lejuar atëherë nga ZRRE. Kjo nënkupton se RAB i mbetur për amortizim, sipas llogarive të KEK-ut është më i ulët se ai i supozuar nga ZRRE. Prandaj, ngarkesat e ardhshme të amortizimit janë më të ulëta sesa që do të ishin po të përdorej llogaritja e ZRRE-së për RAB-in në vitin 2011. Kjo nënkupton se KEK-u nuk mund të rikthejë vlerën e plotë të RAB-it pasi që llogaritja e KEK-ut supozon, në mënyrë të pashprehur haptazi, se ka fituar ngarkesa më të mëdha për amortizimin në periudhën 2006 dhe 2011 sesa ato të lejuara nga ZRRE. KEK-u gjithashtu nuk indeksion RAB dhe RAB_f krahas inflacionit, prandaj RAB-i i tyre i llogaritur është më i ulët se ai i llogaritur nga ZRRE. Kjo nënkupton se KEK-u fiton ngarkesa për zhvlerësim dhe kthim të lejuar më të ulët se sa që do të duhej me qasjen e propozuar nga ZRRE.

Prandaj, ZRRE do të përdor llogaritjen e ZRRE-së për RAB-in e KEK-ut (azhurnuar për informatën e KEK-ut mbi grantet) për qëllime të llogaritjes së të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) të KEK-ut.

5.3 Përshtatja e importit

Kërkesa fillestare e KEK-ut parasheh që çmimi mesatar i ponderuar për importim në vitin 2012 do të ishte €70/MWh. Më 8 shkurt 2012, KEK-u i ka ofruar ZRRE-së informata mbi kontratat e importimit për 2012, ku është cekur se çmimi i vërtetë i importit është €75/MWh dhe jo ai i parashikuar më herët prej €70/MWh.

ZRRE ka ndryshuar kërkesën e KEK-ut dhe ia ka kaluar këtë kosto në MAR. Sipas Rregullit të përcaktimit të çmimeve, çfarëdo dallimi ndërmjet çmimit të realizuar dhe atij të lejuar barazohet me shqyrtimin tarifor të radhës.

Ky ndryshëm ka rritur të hyrat e lejuara për KEK-un për €4.5 milionë.

⁹ KOSTT ka ndjekur një qasje që është konsistente me atë të ZRRE-së.

5.4 Përshatja për shkak të transferimit të transformatorëve 110kV

Më 3 gusht 20011, Qeveria e Kosovës ka vendosur t'i transferojë transformatorët 220/35/10(20) kV dhe 110 kV/x nga KEK-u në KOSTT. Vendimi cekë se të gjitha asetet dhe punëtorët që punojnë në këto asete barten nga KEK-u te KOSTT-i.

Si KEK-u ashtu edhe KOSTT-i i kanë përfshirë vlerat e këtyre aseteve në kostot e ndërlidhura operative dhe të mirëmbajtjes në kërkesën e tyre për tarifë.

Në një takim të mbajtur në lokalet e ZRRE-së më 23 janar 2012, KOSTT-i pohon se grupi punues për implementimin e vendimit të qeverisë për bartjen e aseteve gati ka përfunduar të gjitha detyrat dhe marrëveshjet lidhur me bartjen e aseteve. Sipas KOSTT-it, implementimi tash varet nga finalizimi dhe këto asete duhet t'i barten KOSTT-it duke filluar nga 31 janari 2012. KEK-u, në anën tjetër, pohon¹⁰ se deri më sot, asnjë punëtor dhe asnjë transformator nuk i janë bartur KOSTT-it nga KEK-u dhe se nuk kanë informata mbi vlerën e kostove operative dhe të mirëmbajtjes të cilat janë të ndërlidhura me transferin. KEK-u shton se nuk beson që kjo të jetë e mundur të kryhet shumë shpejtë.

ZRRE konstaton se kostot e ndërlidhura me këto asete duhet t'i alokohen ose KOSTT-it ose KEK-ut por jo të dyve. Duke marrë parasysh se nuk është e sigurtë nëse transferi është bërë apo jo, si dhe ndryshimet në kosto të ndërlidhura të punës dhe mirëmbajtjes, ZRRE propozon që këto kosto, tash për tash, t'i alokohen vetëm KEK-ut.

5.5 Kostot për furnizim intern të energjisë elektrike

KEK-u ka kërkuar një shtesë për koston e furnizimit të brendshëm me energji elektrike për afarizmin e KEK-ut pasi që, sipas tyre, bizneset të cilat konsumojnë energjinë elektrike nga rrjeti i distribucionit, siç është Mihja për shembull, do të fakturohet nga FPEE sipas tarifës së rregulluar. Rrjedhimisht, KEK-u e ka zbritur këtë shtesë nga Të Hyrat e Lejuara të FPEE-së për t'iu shmangur llogaritjes së dyfishtë.

ZRRE konstaton se KEK-u dhe KEDS-i nuk janë ende kompani të ndara dhe, pasi që nuk ka ndonjë marrëveshje të shitjes dhe as tarifë të aprovuar midis tyre, duhet të vazhdojë të aplikohet qasja e mëhershme. ZRRE prandaj ka larguar kërkesën për të hyrat e lejuara për bizneset e KEK-ut dhe ka bërë ndryshime adekuate në pjesën e Të Hyrave nga furnizimi ashtu që të mos bëhet llogaritja e dyfishtë.

Ky ndryshim nuk ka ndikuar në të hyrat e përgjithshme të lejuara të KEK-ut.

¹⁰ Takimi është mbajtur në lokalet e KEK-ut më 26 janar 2012.

5.6 Shpenzimet kapitale për Divizionin e Gjenerimit

Në kërkesën për Tarifën e Gjenerimit, KEK-u parasheh që shpenzimet kapitale për Divizionin e Gjenerimit në vitin 2012 do të jenë 117% më të larta se ato në vitin 2011. Për më tepër, KEK-u pohon se këto investime do të financohen nga rrjedha interne e parasë.

Edhe pse ZRRE nuk ka bërë ndonjë ndryshim në vlerën e shpenzimeve kapitale në Divizionin e Gjenerimit në propozimin e tanishëm, ZRRE kërkon që KEK-u të ofrojë dëshmi të financimit të këtyre investimeve (€60.7 milionë). Nëse nuk ofrohet arsyetim i fortë, ZRRE do të bëjë ndryshimet përkatëse në MAR-in e KEK-ut në vendimin përfundimtar, për të caktuar një vlerë që mund të konsiderohet më reale duke pasur parasysh mungesën e dukshme të financimit.

5.7 Të hyrat e palës së tretë për Operatorin e sistemit të shpërndarjes (OSSH)

ZRRE ka vërejtur se KEK-u ka përfshirë një shumë prej €2.8 milionë si të hyra nga palët e treta në aplikacionin për OSSH.

ZRRE nuk ka bërë ndonjë ndryshim në këtë vlerë por dëshiron të vë në pah se është me rëndësi që KEK-ut të ofrojë një zbrëthim të këtyre të hyrave dhe të cek shumat e pranuar nga të hyrat e tilla gjatë shqyrtimeve të mëhershme tarifore.

6 Bashkërenditja

Kjo pjesë e Raportit Konsultativ prezanton ndryshimet në të Hyrat e Lejuara që paraqiten ndërmjet vlerave të lejuara nga shqyrtimet paraprake të tarifës dhe vlerave reale të raportuara nga KEK sipas shqyrtimit aktual të tarifës.

6.1 Kostot operative dhe të mirëmbajtjes

ZRRE ka vërejtur një dallim ndërmjet vlerave reale të raportuara të Shpenzimeve të mirëmbajtjes në 2010 dhe ato që janë cekur në pasqyrat financiare. KEK-u ka qartësuar se këto rrjedhin nga alokimi i disa shpenzimeve të cilat, në tabelat e ZRRE-së, janë alokuar si kosto të mirëmbajtjes, por që janë bartur në Mallra dhe Shërbime në pasqyrën financiare. Përveç kësaj, ZRRE vëren se ka dallime ndërmjet shpenzimeve operative të lejuara vitin e kaluar dhe atyre të realizuara e të raportuara në SHTE6. Për shkak të praktikave të ndryshme të kontabilitetit, nuk mund të bëhet krahasimi i kostove sipas zërave. Mirëpo, ZRRE konsideron se është e qëlluar të barazohet shuma e kostos së mirëmbajtjes dhe mallrave dhe shërbimeve ndërmjet vlerës së lejuar dhe asaj reale.

Ky barazim ka ulur të hyrat e lejuara të KEK-ut për €8.8 milionë.

6.2 Kostot që kanë të bëjnë me kontestin me KOSTT-in

Më 29 dhjetor 2011, Bordi i ZRRE-së ka vendosur të aprovojë kontestin e pagesës për KOSTT-in. Në këtë kontest, KOSTT-i ka ofruar dëshmi se KEK-u refuzon të paguajë dallimin ndërmjet të hyrave të lejuara të vlerësuar për KOSTT-in, të aprovuara nga ZRRE, dhe të hyrave reale të lejuara. Bordi i ZRRE-së konstatoi se KEK-u duhet t'i bëjë pagesën KOSTT-it por, duke qenë se këto të hyra i kanë tejkaluar të hyrat e parashikuara nga ZRRE, dhe janë të ndërlidhura vetëm me rrjedhën e rritur të energjisë, vendosi se këto të hyra duhet t'iu kthehen konsumatorëve. Për qëllime praktike, duke marrë parasysh rrethanat e shqyrtimit aktual të tarifës, veçanërisht kohën në dispozicion për përfundimin e këtij shqyrtimi tarifor, Bordi i ZRRE-së propozoi që këto të hyra të zbriten drejtpërdrejt nga KEK-u dhe jo nga KOSTT-i.

Ky ndryshim ka ulur të hyrat e lejuara për KEK-un për €3.8 milionë.¹¹

6.3 Kostoja që kanë të bëjnë me importin

Sipas SHTE5, ZRRE i ka lejuar KEK-ut një kosto importi prej €50.1 milionëve. Për të plotësuar nevojat e veta, KEK-u në fakt ka shpenzuar €54.6 milionë. ZRRE prandaj do të barazojë KEK-un për këtë dallim prej 4.5 milionëve.

Ky ndryshim ka rritur të hyrat e lejuara nga KEK-u për €4.5 milionë.

6.4 Kostoja që ka të bëjë me eksportin

Sipas SHTE5, ZRRE i ka lejuar KEK-ut një kosto të importi prej €4.4 milionëve. Gjatë 2011 KEK-u ka eksportuar në vlerë të përgjithshme prej €12.5 milionë, kryesisht për shkak të çmimit të rritur të eksportit krahasuar me atë të parashikuar. ZRRE do të barazojë dallimin në mes të vlerës së realizuar të eksportit dhe atij të lejuar.

Ky ndryshim ka ulur të hyrat e lejuara për KEK-un për €8.1 milionë.

6.5 Kostoja që ka të bëjë me shpenzimet kapitale

Kjo nën-pjesë barazon dallimet ndërmjet fitimit të lejuar dhe amortizimit që shkaktohet nga shpenzimet kapitale të lejuara nga ZRRE në shqyrtimin paraprake të tarifës si dhe shpenzimit capital që ishte implementuar realisht nga KEK-u. Ky barazim përmbledhet në tabelën vijuese:

¹¹ Për më shumë detaje rreth kontestit shihni Vendimin e botuar në faqen e internetit të ZRRE-së

Korporata Energjetike e Kosoves - Bashkërenditja						
		Minierat	Gjenerimi	Distribucioni	Furnizimi	
Shpenzimet Kapitale						
Lejuara (Donacionet)	€000	0.0	0.0	0.0	0.0	
Aktuale (Donacionet)	€000	0.0	0.0	0.0	0.0	
Lejuara (Financim tjetër)	€000	62,600.0	28,000.0	17,900.0	484.0	
Aktuale (Financim tjetër)	€000	87,179.0	21,000.0	13,800.0	840.0	
Zhvlerësimi						
Jetëgjatësia	vite	35.0	16.0	30.0	5.0	
Lejuar	€000	894.3	400.0	255.7	6.9	
Aktuale	€000	1,245.4	300.0	197.1	12.0	
Azhustimi	€000	351.1	-100.0	-58.6	5.1	
Kthimi						
MPKK		13.1%	13.1%	13.1%	13.1%	
Lejuar	€000	4,100.3	1,834.0	1,172.5	31.7	
Aktuale	€000	5,710.2	1,375.5	903.9	55.0	
Azhustimi	€000	1,609.9	-458.5	-268.6	23.3	
Gjithsej	€000	1,961.1	-558.5	-327.1	28.4	
<i>Norma e Interesit</i>		<i>7.00%</i>	<i>7.00%</i>	<i>7.00%</i>	<i>7.00%</i>	
Gjithsej pas Normës së Interesit		€000s	2,098.3	-597.6	-350.0	30.4

Tabela 3: Ndryshimet për shkak të dallimeve ndërmjet shpenzimeve kapitale të lejuara dhe reale

Sipas metodologjisë së re tarifore, asetet iu shtohen Bazës së Aseteve të Rregulluara vetëm nëse janë plotësisht funksionale dhe të gatshme të operojnë. ZRRE prandaj i kërkon KEK-ut që të ofrojë dëshmi se asetet e raportuara si reale dhe ato që janë përfshirë si shpenzime kapitale në SHTE6 janë në fakt tërësisht funksionale. Nëse nuk ofrohen dëshmi të tilla bindëse, ZRRE do të ndryshojë RAB që përdoret si bazë për llogaritjen e të Hyrave të lejuara.

7 Propozimet e ZRRE-së

Kjo pjesë e Raportit Konsultativ prezanton ndryshimet në MAR që paraqiten nga vlerësimi i ZRRE-së mbi arsyeshmërinë e inpueteve të kërkuara nga KEK-u në kërkesën e tyre për tarifa.

7.1 Margjina e shitjes me pakicës

KEK-u ka kërkuar një marginë të shitjes me pakicës prej 5% të kostos së blerjes së energjisë elektrike që nënkupton se një shtesë prej €10.3 milionëve do t'iu kalohet të Hyrave të lejuara.

ZRRE synon t'i përmbahet propozimit të saj fillestar se margjina e shitjes me pakicës duhet të jetë 3% e kostos së Blerjes së energjisë elektrike. Duke qenë se nuk ka zë i veçantë i të hyrave për një kthim të lejuar të asetëve të FPEE-së, ZRRE do të konfirmojë çdo vit nëse Margjina e aprovuar e shitjes me pakicës ofron fitime të arsyeshme të investimeve të bëra nga PES. Për ta bërë këtë, ZRRE do të llogarit një WACC të nënkuptuar duke pjesëtuar të hyrat nga Margjina e shitjes me pakicës në çdo vit me RAB-in për FPEE-së në atë vit. Fitimi i nxjerrë nga kjo do të krahasohet me WACC të aprovuar për

të licencuar të tjerë të rregulluar. Kur fitimi është më i ulët se WACC i aprovuar për të licencuar të tjerë, Margjina e shitjes me pakicës do të ngritet sipas nevojës.

Për shembull, në SHTE5, kostoja neto totale e lejuar e blerjes së energjisë elektrike para subvencioneve për import ishte përafërsisht €168 milionë. Nëse aplikohet margjina e shitjes me pakicës prej 3%, fitohen të hyrat nga margjina për PES prej rreth 5 milionë eurove. RAB-i mesatar vjetor për 2011 ishte përafërsisht 6 milion euro. Norma e nënkuptuar e fitimit prandaj do të ishte 80% ose shumë më e lartë se WACC i lejuar për të licencuar të tjerë të rregulluar prej 13.1%. Prandaj, në këtë rast, nuk do të kishte nevojë të rregullohej margjina.

Ky propozim e ZRRE-së ul të hyrat e lejuara për KEK-un për 4.3 milionë.

7.2 Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (WACC)

ZRRE vëren se KEK-u ka përdorur nivelet reale të leverazhit (gearing-ut - raporti i borxhit të kompanisë kundrejt ekuitetit) në llogaritjet e tyre të WACC-ut. ZRRE pohon se është me rëndësi të shqyrtohet se cili do të ishte niveli optimal i leverazhit për shërbimet publike – ai i cili siguron një kosto më të ulët të përgjithshme të kapitalit dhe që, në të njëjtën kohë, nuk inkurajon leverazh të tepërt që do të rrezikonte pozitën financiare të të licencuarve. ZRRE prandaj sugjeron që një leverazh ndërmjet 0.4 dhe 0.7 dhe ka përdorur këtë parim në llogaritjen e WACC-së për të licencuarit. Kur leverazhi i realizuar është më i ulët se 0.4 atëherë kufiri më i ulët prej 0.4 është përdorur për të llogaritur WACC-un dhe, në rastet kur leverazhi i realizuar është më i madh se 0.7, atëherë përdoret 0.7 për të llogaritur WACC-un. Vlerat e realizuara të përshtatjes të cilat qëndronin ndërmjet 0.4 dhe 0.7 janë përdorur si të tilla për llogaritjen e WACC-ut.

Komponenta	----- KEK -----				----- Propozimi i ZRRE-së -----				Llogaritja
	Mihja	Gjenerimi	OSSH	FP	Mihja	Gjenerimi	OSSH	FP	
Norma pa rrezik									
Nominale	10.0%	10.0%	10.0%	10.0%					a
Eurozone HCIP (nëntor 2011)	3.0%	3.0%	3.0%	3.0%	Shih konsultimin e ZRRE-se për WACC				b
Reale	7.0%	7.0%	7.0%	7.0%					c=a-b
Për llogaritje	7.0%	7.0%	7.0%	7.0%	6.0%	6.0%	6.0%	6.0%	d
Leverazhi	0.87	0.21	0.00	0.00	0.70	0.40	0.40	0.40	e
Kostoja e borxhit									
Premia e rrezikut të borxhit							2.5%	2.5%	f
Premia e kompanive të vogla							0.6%	0.6%	g
Kostoja e borxhit	3.7%	3.5%			3.7%	3.5%	9.1%	9.1%	h=d+f+g
Kostoja e ekuitetit									
Premia e rrezikut	6.0%	6.0%	6.0%	6.0%	6.0%	6.0%	6.0%	6.0%	i
Beta	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	j
Kostoja e ekuitetit pas tatimit	13.0%	13.0%	13.0%	13.0%	12.0%	12.0%	12.0%	12.0%	k=d+i*j
Norma e tatimit për korporata	10.0%	10.0%	10.0%	10.0%	10.0%	10.0%	10.0%	10.0%	l
Kostoja e ekuitetit para tatimit	14.4%	14.4%	14.4%	14.4%	13.3%	13.3%	13.3%	13.3%	m=k/(1-l)
WACC									
WACC-ja reale para tatimit	5.2%	12.2%	14.4%	14.4%	6.6%	9.4%	11.6%	11.6%	n=e*h+(1-e)*m
Eurozone HCIP (shtator 2011)	3.0%	3.0%	3.0%	3.0%	3.0%	3.0%	3.0%	3.0%	o
WACC nominale e fituar para tatimit	8.2%	15.2%	17.4%	17.4%	9.6%	12.4%	14.6%	14.6%	p=n+o

Tabela 4: Llogaritja e Kostos Mesatare të Matur të Kapitalit për KEK-un

7.2.1 WACC e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

Më 29 dhjetor 2011, Bordi i ZRRE-së, pas kryerjes së konsultimit publik lidhur me nivelin e duhur të Mesatares së Ponderuar të Kostos së Kapitalit (WACC) për kompanitë komerciale që ofrojnë shërbime publike, ka aprovuar një vlerë indikative të WACC që duhet të përdoret për qëllime të llogaritjes së të Hyrave maksimale të lejuara. Kjo llogaritje indikative e WACC-ut është përcaktuar në 14.5% (para tatimit, vlerë nominale, me një shkallë të supozuar inflacioni prej 3% ashtu siç është dhënë në Tabelën 4.

Në ndërkohë, më 24 janar 2012, Bordi i ZRRE-së ka pranuar një shkresë nga Këshilltarët e Qeverisë së Kosovës mbi Transaksionin e KEDS-it. Në këtë shkresë, e cila është publikuar në ueb faqen e ZRRE-së së bashku me këtë Raport Konsultativ, Këshilltarët e Transaksionit (KT) pohojnë se, bazuar në reagimet e pranuar nga investitorët, niveli i WACC-së i përcaktuar nga ZRRE nuk është i mjaftueshëm për të garantuar investimin në biznesin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH). Ndër të tjera, Këshilltarët e Transaksionit sugjerojnë që WACC të përcaktohet në së paku 16.5%.

ZRRE konsideron se WACC indikative e përcaktuar më herët merr parasysh rrezikun e perceptuar nga investitorë privatë për investim në Kosovë. Llogaritja e këtyre vlerave përfshin parametrat e rrezikut që janë specifike për këtë shtet, të cilat japin WACC-un që siguron një fitim të arsyeshëm për investitorë të mundshëm privatë në Kosovë. Mirëpo, ZRRE është e gatshme t'i përgjigjet pozitivisht kërkesës së KT-së dhe propozon një WACC prej 15% (nominal, para tatimit), i cili do të përdoret për llogaritjen e MAR-it. ZRRE beson se kjo paraqet një hap përpara ndaj reagimit të investitorëve, i cili merr parasysh WACC-un indikativ përkatëse të përcaktuar më herët nga ZRRE.

Ky propozim ka rritur të Hyrat e lejuara të KEK-ut për 0.2 milionë EUR.

7.3 Çmimi i eksportit

KEK-u parasheh që çmimi mesatar i eksportit për vitin 2012 do të jetë 30€/MWh dhe prandaj zvogëlon vlerën e të hyrave të lejuara për vetëm €5 milionë. Çmimi mesatar i eksportit për KEK-un ishte 45€/MWh në vitin 2011.

ZRRE ka parasysh faktin se rritja e çmimit të importit nënkupton që edhe çmimi i tregut të energjisë elektrike pritet të rritet në vitin 2012 krahasuar me 2011. ZRRE prandaj konsideron se një çmim i qëlluar i eksportit që mund të përfshihet në të hyrat e lejuara duhet të jetë të paktën barazi me mesataren e vitit 2011, nëse gjithçka tjetër mbetet e njëjtë.

ZRRE prandaj ka ndryshuar kërkesën e KEK-ut mbi çmimin mesatar të eksportit në €45/MWh. ZRRE ka parasysh se, si për importet, çfarëdo dallimi ndërmjet vlerave të lejuara dhe atyre të realizuara do të barazohen në shqyrtimin vijues të tarifës.

7.4 Kostoja e lejuara operative dhe e mirëmbajtjes

KEK-u ka kërkuar një vlerë më të ulët të Kostos Operative dhe të mirëmbajtjes (O&M) me SHTE6 sesa që ZRRE kishte lejuar me SHTE5. ZRRE mirëpret këtë dhe inkurajon KEK-un që të vazhdojë edhe më tej me përmirësimin e efikasitetit të O&M. ZRRE prandaj ende nuk ka bërë ndonjë ndryshim në kërkesën e KEK-ut lidhur me koston e O&M. Përkundër kësaj, ZRRE i kërkon KEK-ut që të ofrojë arsyetim për çdo nën-kategori të kostove për O&M për çdo divizion të KEK-ut. Në mungesë të argumenteve bindëse për lejimin e këtyre kostove, ZRRE do të bëjë ndryshimet përkatëse për koston e lejuar të KEK-ut për O&M.

8 Përmbledhje

ZRRE ka parasysh se – bazuar në ndryshimet, barazimet dhe propozimet e ZRRE-së – tarifa mesatare për energji elektrike duhet të rritet për 7.6% në mënyrë që KEK-u të mbledhë të hyra të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e arsyeshme të propozuara nga ZRRE sipas këtij shqyrtimi tarifar. Për shkak të faktit se disa çështje të ngritura nga ZRRE në këtë Raport Konsultativ janë ende në shqyrtim e sipër, ZRRE potencon se vlera prej 7.6% mund të ndryshojë në vendimin final për tarifa.